



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

KËRKESË PËR INFORMIM (SHPJEGUESE)
(Hapat e përgjithshëm që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)

- **Çdo person** gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- **Çdo person** ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal, ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
- **Kërkesa për informim** bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 1. emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 2. adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 3. përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 4. formatin në të cilin preferohet informacioni;
 5. çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
- **Çdo person**, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- **Ankimi administrativ** pranë Zyrës së Komisionerit bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 1. ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 2. ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
- **Kërkesa për informim** trajtohet nga ana e autoritetit publik sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
- **Kur kërkesa është e paqartë** në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e saj, autoriteti publik kontakton menjëherë personin për të bërë sqarimet e nevojshme, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës.
- **Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës** autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarin.
- **Shërbimet e administratës publike** janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut.
- **Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore**, si dhe subjektet përfituese, sipas Ligjit Nr. 10039/2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë, ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër.
- **E drejta e informimit kufizohet** vetëm sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.